



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETITIT  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2023

**Lënda:** Përgjigje kërkesës së paraqitur nga Z. P.V.  
Z. P.V.  
Email - \_\_\_\_\_@gmail.com

I nderuar z. V.,

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, dërguar me email Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti) bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit“, për vënien në dispozicion të dosjes apo dokumentet të cilat ekzistojnë për familjen V. që jetonte në fshatin Curraj Eper Nikaj-Mertur Tropojë, dhe informacion nëse ekziston për shtetasin Gj.V. i vrarë nga forcat komuniste në zonën e Tepelenës gjatë luftës së dytë botërore, ju informojmë si më poshtë:

Së pari baza ligjore në kërkesën tuaj për informacion, është vendosur bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit“. Por nga shqyrtimi i objektit të kërkesës vërehet se kërkesa juaj për informacion i nënshtrohet dispozitave proceduriale për mënyrën se si të merret informacioni, sipas dispozitave njohëse të ligjit nr. 45/2015“Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar“.

Në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, ligjit nr. 45/2015, kërkesa juaj me email për vënie në dispozicion të dosjes apo dokumentacion, është përcjellë në strukturat përkatëse për tu trajtuar. Nga komunikimi me këto struktura, është konstatuar se në datën 03.02.2023, jeni vënë në dijeni me email, për të plotësuar të dhëna të tjera të nevojshme për të identifikuar apo lokalizuar sa më mirë dokumentin/informacionin.

Për ecurinë e praktikës tuaj nga ana e Autoritetit, do të njoftoheni nga strukturat përkatëse me shkresë/email në adresën e paraqitur në kërkesën drejtuar Autoritetit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin,

**Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit**

**L. Cocoli**

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**Suela Prençi**